



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 3182 Prot.

Tiranë, më 9.6, 2020

URDHËR

NR. 165, DATË 9.6.2020

“PËR

NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 14, DATË 16.01.2020 “PËR SHPALLJEN E “THIRRJES SË PESTË” NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 6 të Vendimit nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, i ndryshuar dhe të pikës 7 të urdhrit nr. 351, datë 29.05.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid-19”,

URDHËROJ:

- Në “Metodologjinë dhe Planin e Veprimit në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, Thirrja e Pestë”, bashkëlidhur urdhrit nr. 14, datë 16.01.2020, bëhen këto ndryshime:
 - Në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3, data “9 mars 2020” zëvendësohet me datën “12 qershor 2020”.
 - Shkronja “b” e pikës 4 ndryshon si më poshtë:
“ b) Programi fillon më datë 12 qershor 2020 dhe përfundon më datë 12 shtator 2020.”.
- Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI

Besa SHAHINI

